

SPECIFIKIME TEKNIKE

REAHBILITIM I PARKUT CLIRIM –RAJONI NR 1

BERAT 2026

PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1 PASTRIMI I KANTIERIT

2.1.1 Pastrimi i kantierit

Ne fillim te kontrates, per sa kohe qe ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet te heqe nga territori I punimeve te gjitha materialet organike vegjetare dhe ndertuese, dhe te djege te gjitha pirgjet e mbeturinave te tjera.

2.1.2 Skarifikimi

Largime te medha me ekskavatore dhe skarifikime, te kryera me dore ose makine nga terrene, nga çfaredo lloj toke, qofte edhe e ngurte (terrene te ngurte, rere, zhavori, shkembore) duke perfshire levizjen e rrenjeve, trunqeve, shkembinjve dhe materialeve me permasa qe nuk kalojne 0,30 m³, duke perfshire mbrojtjen e strukturave te nendheshme si kanalizime uji, nafte ose gazi etj dhe duke perfshire vendin e depozitimit te materialeve brenda ne kantier ose largimin e tyre ne rast nevojë.

2.1.3 Heqja e pemeve dhe shkurreve me te larta se 1.5 m

Ne pergjithesi duhet patur parasysh, qe gjate punimeve te pastrimit te mos demtohen ato peme te cilat nuk pengojne ne rehabilitimin ose ne ndertimin e objektit te ri. Ne rastet kur heqja e tyre eshte e domosdoshme, duhet te merren masa mbrojtese ne menyre qe gjate rrezimit te tyre te mos demtohen personat dhe objektet perreth. Per kete, per pemet qe jane te larta mbi 10 m, duhet qe prerja e tyre te behet me pjese nga 3 m. Pjesa qe pritet, duhet te lidhet me litar ose kavo dhe te terhiqet nga ana ku sigurohet mbrojtja e personelit dhe e objekteve.

2.1.6 Mbrojtja e vendit te pastruar

Kontraktori duhet te ngreje rrjete te pershtatshme, barriera mbrojtese, ne menyre qe, te parandaloje aksidentime te personave ose demtime te godinave rrethuese nga materialet qe bien, si dhe te mbaje nen kontroll territorin, ku do te kryhen punime

2.1.7 Punimet e lyerjeve

Ne fillim te procesit te lyerjes behet paralysterja e siperfaqeve te pastruara mire me vinovil te holluar (Astar plastik). Ne fillim behet pergatitja e astarit duke bere perzierjen e 1 kg vinovil te holluar me 3 liter uje. Me perzierjen e pergatitur behet paralysterja e siperfaqes vetem me nje dore. Norma e perdorimit eshte 1 liter vinovil i holluar qe duhet te perdoret per 20m² siperfaqe. Me

pas vazhdohet me lyerjen me boje akrelidik. Kjo boje ndryshon nga boja plastike sepse ka ne perberjen e saj vajra te ndryshme, te cilat e bejne bojen rezistente ndaj rrezeve te diellit, ndaj lageshtires se shirave, etj. Ne fillim behet pergatitja e perzierjes se bojes akrelidik me uje. Lengu I bojes hollohet me uje ne masen 20-30 %. Kesaj perzierje I hidhet pigmenti deri sa te merret ngjyra e deshruar. Pastaj, behet lyerja e siperfaqes. Lyerja behet me dy duar. Norma e perdorimit eshte 1 liter boje akrelidik I holluar ne 4-5 m² siperfaqe (ne varesi te ashpersise se siperfaqes se lyer). Personeli, qe do te kryeje lyerjen duhet te jete me experience.

4.2.1 Riparimi i dysHEMEVE me pllaka

Riparimi per pllakat e demtuara ose per ato pllaka qe mungojne, te behet ne kete menyre: Pllakat e demtuara duhen hequr megjithe llaçin ne nje trashesi te pakten 2 cm. Pastaj duhet, qe vendi te pastrohet dhe te lahet me uje me presion. Pllakat e reja te jene me te njejten ngjyre dhe me dimensione te njejta si pllakat e vjetra dhe te vendosen ne llaçin e shtruar. Llaçi per riparim duhet te pergatitet me permbajtje: per 1,02 m² pllaka nevojiten 0,02 m³ llaç te tipit m-15 me 4 kg çemento (marka 400). Pastaj, duhet qe fugat te mbushen me masen perkatese (bojak), te pastrohen dhe te kryhen te gjitha punet e tjera.

3.1 Furnizim dhe vendosje stolash

Materiali

Stolat duhet të jenë:

- konstruktion çeliku të galvanizuar;
- të lyer elektrostatisht;
- elementë druri ose WPC;
- rezistent ndaj korrozionit.

Vendosja

- Fiksim me bulona inox.
- Betonim i bazës sipas rastit.
- Kontroll i stabilitetit.

3.2 Furnizim dhe vendosje koshash

Materiali

- Çelik i galvanizuar.
- Trashësi minimale 2 mm.

- Lyerje elektrostатike.

Vendosja

Fiksim në bazament me bulona inox

4.1 Përpunimi i tokës

Punimi përfshin:

- pastrim të sipërfaqes;
- frezim të tokës;
- nivelim;
- përgatitje për mbjellje.

Thellësia minimale e punimit: 15–20 cm.

4.2 Pleh organik

Përdoret pleh organik i dekompozuar mirë.

Doza:

0.5 kg/m²

Shpërndahet në mënyrë uniforme dhe përzihet me shtresën sipërfaqësore të tokës.

4.3 Mbjellja e barit

Përfshin:

- shpërndarjen uniforme të farës;
- mbulimin me shtresë të hollë dheu;
- rulimin;
- ujitjen.

Bari duhet të arrijë mbulim uniform pa boshllëqe.

5. Riparimi i ndriçuesve

Punimi përfshin:

- kontrollin e instalimit elektrik;
- zëvendësimin e llambave të dëmtuara;
- zëvendësimin e kabllave ose lidhjeve të dëmtuara;
- kontrollin e tokëzimit;
- testimin përfundimtar të funksionimit.

Materialet elektrike duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve IEC dhe EN.

Kërkesa të përgjithshme

- Të gjitha materialet duhet të jenë të reja dhe të certifikuara.
- Punimet duhet të realizohen sipas kushteve teknike të ndërtimit dhe standardeve shqiptare në fuqi.
- Gjatë punimeve duhet të mbrohet gjelbërimi ekzistues.
- Pas përfundimit të punimeve, zona duhet të pastrohet dhe të dorëzohet në gjendje të rregullt.
- Sipërfaqet e dëmtuara gjatë punimeve duhet të rikthehen në gjendjen e tyre fillestare.

Përgjithësi: V.Karabina

